



# Artizanët & Pazari

# Artizanët & Pazari

Çfarë e bën të veçantë pazarin? Sigurisht njerëzit: një shkrirje tregimesh, aftësish, familjesh, ngjyrash, ushqimesh të shijshme e produkteve kreative për t’u shijuar gjatë vizitës në Gjirokastrë. Pra, leri shqisat të lira dhe fillo të zhytesh në pazar dhe në historinë e tij. Nëse doni të kuptoni si është jeta në Gjirokastrë, mos e humbisni mundësinë për t’u takuar me artizanët e pazarit dhe për të parë çfarë bëjnë! Mësoni rreth zanateve të lashta dhe teknikave që ata përdorin për të bërë prodhimet tradicionale, pavarësisht nëse janë prej guri, pambuku, leshi, metali ose lulesh, siç është çaji i mrekullueshëm i malit.

Vizitoni Anastasin, drugdhendësin dhe gruan e tij në punishten e tyre dhe shihni se si e kthen drurin në objekte të mrekullueshme dhe suvenire që bartin vlerat tradicionale të qytetit. Margarita do të ndajë me ju pasionin e saj për qëndisje, ndërsa në qendrën Gjiro Art, Lubi dhe Eli do t’ju lënë të përdorni tezgjahet tradicionale, me të cilët ato punojnë qillimat e tyre shumëngjyrëshe. Beqiri, kovaçi, do t’ju tregojë punishten e tij tradicionale ku babai dhe gjyshi i tij ushtruan artin e punimit të metalit. Sot ai po i mëson djalit të tij të bëjë të njëjtën gjë. Çdo produkt artizanal që blini, u vjen në ndihmë artizanëve që të ruajnë në shekuj mjeshtritë dhe veprat artizanale, si dhe sjell të ardhura për



BEQIR AND BERNARD LLANO - Kovaçë

Zanati i kovaçit është shumë i rrallë në ditët e sotme në Gjirokastrë. Megjithatë Beqir Llano, familja e të cilit e ka praktikuar këtë zanat të lashtë për pesë breza, është i vendosur ta mbajë gjallë këtë njohuri.

“Dëgjova trokitjen e çekicit në hekur prandaj u ktheva”, më tha një turist hollandez kur hyri në punishten time. Babai i tij kishte qenë kovaç. Njohu zhurmën dhe u bë kureshtar.

E kam mësuar këtë zanat nga babai im dhe ai e ka mësuar nga babai i tij. Unë ia trashëgova djalit, Bernardit, i cili është brezi i pestë i kovaçëve në familjen tonë. Vite me parë kemi pasur dyqanin tonë në pazarin e Gjirokastrës, aty ku tani është rruga e zejtarëve. Rrugës, të paktën, i mbeti emri. Në ato vite, në pazarin e Gjirokastrës kish zeje nga më të ndryshmet. Tani kam një punishtë të vogël në shtëpinë time, ku punoj bashkë me djalin. Prodhojmë vegla të ndryshme sipas kërkesave të klientëve. Me pëlqen fakti që njerëzit që merren me restaurimin e shtëpive karakteristike, vijnë dhe porositin pjesë të ndryshme, që përdorin gjatë restaurimit. Puna jonë është e vështirë, por e bukur. Të shohësh dyert gjirokastrite “të qëndisura” me produkte hekurit të punuara në punishten time, është kënaqësi e madhe. Dëshira ime për ta vazhduar këtë punë lidhet me pasionin që kam për ta mbajtur gjallë profesionin e familjes sime dhe shpresoj që im bir do ta vazhdojë atë. Për më tepër, është më mirë të merret me këtë punë sesa të vijë verdallë pazarit të Gjirokastrës duke mos bërë asgjë. Është shumë më mirë të punosh si një kovaç për pak lekë dhe të jesh i lumtur për atë që bën. Qesh!



ANASTAS PETRIDHI - Drugdhendës

Anastas Petridhi është një drugdhendës i njohur, që ka një dyqan në pazarin e Gjirokastrës

Kam filluar të punoj në artizanat në vitin 1986. Gjithmonë e kam pëlqyer këtë zanat dhe punoj me përkushtim e pasion. Më vonë hapa me vëllain tim një punishtë të vogël pranë shtëpisë ku punoja. Para disa vitesh vendosa të hap një dyqan në pazar, ku punoj bashkë me gruan.

Të punoj jo vetëm për veten, por të paraqes vlerat tradicionale të qytetit - kjo është motoja ime.

Kryesisht, turistët duan të blejnë objekte të vogla që të mund t’i marrin me vete. Pra dhe unë punoj sipas kërkesave të tyre. Megjithatë, motivet e produkteve të mia janë motivet e qytetit: kalaja, shtëpitë karakteristike, muzetë, simbolet e ndryshme etj. Gjithashtu punoj për klientët lokalë që duan të restaurojnë objekte të ndryshme tradicionale ose pjesë të shtëpive të tyre, - rozeta për tavanet e shtëpive të Gjirokastrës, etj. Kur turistët hyjnë në dyqan, ata i afrohen tryezës time të punës dhe i vlerësojnë teknikat e gdhendjes dhe modelet e mia të shumëllojshme. Ata shohin se si një copë druri e thjeshtë shndërrohet në një simbol të bukur të qytetit tonë të gurtë.



ELI PASKALI

“A janë punime dore këto?” pyesin turistët sapo futen në dyqan. Dhe unë me plot kënaqësi u përgjigjem: “Po, janë të gjitha punime dore”. Për të qenë më bindëse, u tregoj dhe procesin e punës. Specialiteti im janë teknikat e ndryshme tradicionale si qëndisja, puna me grep, puna me shtiza, punim shajaku etj. Gjithashtu, në dyqanin tim shes edhe bizhuteri dhe gliko. Përgatis dhe shes edhe bimë medicinale dhe barëra tradicionale.

Të gjitha këto mjeshtri i kam të trashëguara nga gjyshja. Kam pasur gjithmonë dëshirë që t’i mësoj brezit të ri të çdo gjë që di. Meqë vetë nuk kam vajzë, këtë zanat ua kam mësuar shumë vajzave të reja dhe grave të lagjes sime. Djali im punon me mua në dyqan dhe i pëlqen shumë ky biznes. Është jo vetëm një mundësi fitimi për ne, por edhe një punë që më jep kënaqësi. Artizanati është pasioni im.



MUHEDIN MAKRI - Gurgdhendës

Jam 79 vjeç dhe punoj si gurgdhendës. Edhe babai dhe gjyshi im ishin gurgdhendës. Unë ua mësova zanatin e gurgdhendjes djemve dhe nipit dhe kënaqem kur i shoh që nxjerrin nga duart e tyre punime të gdhendura në gur nga më të bukurat. Gjithashtu artin e gdhendjes së gurit ua kam mësuar shumë të rinjve nga qyteti. Është ndjenjë e bukur kur brezit të ri i pëlqen të punojë me gur dhe kur ky brez i vlerëson traditat e qytetit tonë.

Gjirokastra është qytet i gurtë dhe guri është elementi kryesor i tij. Zanati nuk më jep vetëm të ardhura, por mbi të gjitha me jep kënaqësi. Kam pasur shumë talent në gdhendjen e gurit dhe jam vlerësuar gjatë gjithë jetës për aftësitë e mia. Së fundi fitova edhe titullin “Më i miri i vendit” në një konkurs kombëtar. Punoj modele nga mië të ndryshmet, por kryesisht ato me motive nga qyteti.



IDEA GJIROKASTËR

Fereniki dhe bashkëshorti i saj Aureli, kanë një biznes të vogël në Pazar. Në vitin 2010, kur ata u kthyen nga Greqia vendosën të merrnin një dyqan në pjesën historike të qytetit dhe të krijonin punimet e tyre artizanale.

“Dyqanin e kemi hapur nga dëshira dhe pasioni për punën artizanale dhe i jemi përkushtuar të dy, duke ndihmuar njëri-tjetrin. Mوندohemi të sjellim gjëra të reja për të shtuar gamën e produkteve tona”.

Dyqani i tyre është i mbushur me punime dore por njëkohësisht dhe me stil modern. Ato që spikasin më shumë janë prodhimet e shumëllojshme të bizhuterisë, të punuara me delikatesë dhe përkushtim. Sipas Fereniqit është e rëndësishme që puna artizanale të trashëgohet por njëkohësisht të pasurohet dhe ndërthuret me elementë të rinj dhe modernë, që i përshlatan kohës dhe e bejnë produktin më tërheqës për turistët.



MARGARITA MASTORA

Kur njerëzit më pyesin kush ma mësuar zanatin, unë u përgjigjem: puna. Hapat e para m’i mësoi mamaja, por pastaj meqë e kisha shumë pasion punën e dorës, mësova vetë shumë teknika të ndryshme (punë me grep, qëndisje, punë me gjilpërë, punë me shtiza, qëndisje në makinë). U përpoqa të mësoja sa më shumë të mundja edhe nga shoqet, për të krijuar modelet dhe produktet e mia. Shpeshherë bënim mes nesh dhe gara se kush do të dilte më e mira dhe kush do të punonte me shpejt. Doja të dilja gjithmonë e para dhe punoja gjithë natën për të mbaruar, edhe pse mamasë nuk i pëlqente kjo gjë.

Dyqani im është si një ekspozitë e bukur punimesh dore.



RUHIE BINERI

“Zanati nuk të lë kurrë pa bukë”, më thoshin prindërit. “Por zanatin duhet edhe ta duash”.

Unë punoj në tezgjah dhe për mendimin tim, të qëniti artizan është një dhunti. Edhe pse jam e moshuar, vazhdoj të punoj. Zanati më mban gjallë dhe më largon disi nga problemet e jetës. Në dyqanin tim të vogël në pazar shes rrugica dhe qillima të punuar nga artizane të ndryshme të zonës. Më pëlqen të ndaj njohuritë dhe përvojën time duke mësuar edhe gratë e tjera të nxjerrin nga dora produkte cilësore duke përdorur teknikat tradicionale. Vizitorët në dyqanin tim gjejnë jo vetëm rrugica dhe qillima, por mund të provojnë edhe si punohet në tezgjah.



DUART E ARTA - VJOLLCA MEZINI

Në vitin 1993 kishte shumë kërkesa nga të huajt për punime dore. Kështu, fillova të bashkëpunoja me shumë gra artizane dhe të shisja produktet në Greqi. Të gjitha ne bëjmë punime dore duke përdorur teknika tradicionale. Tani kam hapur dyqanin tim në pazarin e Gjirokastrës, ku vizitorët mund të gjejnë punime të shumë grave dhe vajzave gjirokastrite.

Biznesin tim e kam pagëzuar “Duart e Arta”, sepse vërtet janë të arta duart e artizaneve që punojnë në procese tradicionale si: puna me shtiza, puna me grep, qëndisja etj. Unë bëj edhe modele (me motive të qytetit), si dhe punoj edhe vetë shumë nga punimet e dorës. Kam mësuar nga gjyshja, e cila ka punuar me murgeshat italiane gjatë Luftës së Dytë Botërore.



LEONORA CICI

Të nxjerrësh diçka nga duart e tua është kënaqësi.

Fillova të qëndisja kur isha 6 vjeç. Mamaja më mësoi bazat e punës me grep dhe qëndisjes. Më vonë mësova edhe nga shoqet. Në moshën 17-vjeçare fillova punë tek ish-ndërmarrja “Artistikja” në Gjirokastrë. Atje punova 13 vjet dhe u specializova në teknikat e endjes dhe të tezgjahut. Që prej vitit 2005 punoj në biznesin tim në pazarin e Gjirokastrës, ku bëj gjithashtu punime dore me grep dhe qëndisje. Fatkeqësisht, vajzës sime nuk i pëlqen ky profesion, por unë përpiqem t’i mësoj brezit të ri zanatin e bukur të qëndisjes dhe punës në tezgjah duke trajnuar me sa kam mundësi artizanet e reja.

Më pëlqen të përdor motive nga Gjirokastra, sepse janë shumë të bukura - siç është vetë ky qytet.

Historia e Pazarit dhe zejeve në Gjirokastrë lidhet me njerëzit. Pazarit i Gjirokastrës është zemra e qytetit historik. Pazarit, i vendosur në mes të kthesave të kodrës, lidh kështjellën, në pjesën e sipërme me disa nga lagjet historike në pjesën e poshtme. Megjithatë Pazarit i Gjirokastrës është më shumë se një labirint ndërtesash të bukura. Përgjatë këtyre kalldrëmeve të ngushta, artizanët e mjeshtër të famshëm të Gjirokastrës mësuan dhe përsosën aftësitë e tyre. Pazarit nuk e ka zanafillën aty ku është tani. Pazarit i parë i qytetit ndodhej jashtë pjesës fundore të kalasë, poshtë vendit ku është sot Kulla e

Sahatit. Por shumë shpejt qyteti u zgjerua. Në shekullin XVII, Gjirokastra ishte një qytet në rritje, si nga tregtia edhe nga rëndësia, kështu që guvernatori osman Memi Pasha planifikoi dhe ndërtoi një qendër të re tregtare edhe më të madhe. Kjo qendër u njoh si Pazarit i Ri, kurse sot e quajmë thjesht Pazarit. Pazarit i ri u bë shpejt pjesë e jetës së qytetit, jo vetëm për tregtinë. Kjo zonë përfshinte një xhami, banesa dhe punishte artizanale, si dhe dyqane tradicionale. Gjatë kësaj kohe pazarit mori një identitet të vetin, si vendi ku gjirokastritët kryenin shumicën e mjeshtërive

dhe aktivitetit tregtar.


Në vitin 1872 pazarit u godit nga një fatkeqësi: një zjarr shkatërrimtar e rrënoi thuajse plotësisht. Megjithatë, qytetarët e Gjirokastrës e rindërtuan dhe i dhanë pazarit një jetë të re. Si rezultat, shumica e ndërtesave të pazarit që shihni sot, u ndërtuan në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.

Njerëzit që jetojnë këtu vazhdojnë traditat e mjeshtërive dhe artizanatit të shekujve më parë. Disa prej tyre mund t'i takoni gjatë turit. Historikisht, shumë prej zejeve artizanale ushtroheshin nga grupe prej 10-15

artizanësh, siç është kolektivi i sotëm i endësive dhe qëndistareve "Gjiro Art".

Sidoqoftë, zanate të caktuara identifikohen me një person ose familje të caktuar, siç është kovaçi Beqir Llano, familja e të cilit e ka ushtruar këtë zanat për shumë breza me radhë.

Sot, më shumë se 100 vjet që nga pavarësia e Shqipërisë nga Perandoria Osmane, artizanët e qytetit të Gjirokastrës ende praktikojnë një numër zanatesh të rëndësishme që janë zhdukur nga zonat fqinje. Duke shëtitur nëpër pazar bëji sytë katër dhe zbulo këto mjeshtëri nga dalin produkte lokale si: qëndisimat e mëndafshit, pëlhurat e pambukut, qilimat e endur, druri dhe guri i



# Artizanët & Pazarit

Harta dhe kontaktet

01 Beqir Llano

02 Muhedin Makri

03 Anastas Petridhi

04 Leonora Cici

05 Vjollca Mezini




06 Ruhie Bineri

07 Idea Gjirokastra


08 Margarita Mastora

09 Eli Paskali





## Anastas Petridhi

-  Pazar (03)
-  09:00 - 21:00
-  0692617562


## Muhedin Makri

-  Pazar (02)
-  08:00 - 20:00
-  0693191279




## Margarita Mastora

-  Pazar(08)
-  09:00 - 20:00
-  0695691247
-  *margarita mastora*

## Eli Paskali

-  Pazar (09)
-  09:00 - 21:00
-  0698726366

## Vjollca Mezini

-  Pazar (05)
-  08:00 - 22:00
-  069 316 1121


<https://doraearte.wordpress.com/>


## Ruhie Bineri

-  Pazar (06)
-  10:00 - 18:00
-  0692542122

## Idea Gjirokastra

 Pazar (07)

 09:00-21:00

 0694248809

 idea.gjirokastra

*fereniqiidea@gmail.com*

*fereniqiidea.daportofolio.com*

## Leonora Cici


 Pazar (04)

 09:00 - 20:00

 0694219190

## Beqir Llano

 Pazar (01)

 09:00 - 20:00

Teksti

**Ilir Parangoni, CHwB Albania**

Harta e ilustruar

**Gjergji Zhuka**

Përmbajtja dhe Layout Design

**CHwB Albania**

© Të gjitha të drejtat të rezervuara

